



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.09.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Kompani e Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës** “ , **Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-052-211**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Kompania e Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K.**, e dt.29.09.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës** “ , **Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-052-211**, Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 17.06.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** , i publikuar me datë: 17.06.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.29.09.2022, Operatori Ekonomik **Kompani e Sigurimit Alpha Private Security SH.P.K.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **“Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës “ , Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-052-211.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ne si Autoritet Kontraktues i respektojmë të gjitha ligjet në fuqi dhe nuk kemi mundësi që të interpretojmë mendimet e Operatorëve Ekonomik.

Nëse një Operator Ekonomik konsideron që ne si Autoritet Kontraktues kemi bërë shkelje apo jo shkelje të ndonjë ligji, nuk është autoritet përcaktues, autoritet përcaktues janë instanca tjera. Asnjë nga kriteret në dosjen e tenderit nuk e favorizon specifikisht dike, të gjitha kriteret në dosjen e tenderit janë në harmoni me LPP-ën.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës